



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 163, Datë 20.06.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “H&K @ VALA MAR RESIDENCES” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; të ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 925/3 prot., datë 14.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “H&K @ VALA MAR RESIDENCES” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 98, datë 09.05.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H&K @ Vala Mar Residences” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/18 prot., datë 10.05.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.05.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 570/1 prot., datë 18.05.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 570/2 datë 06.06.2022 dhe e-mailin e datës 10.06.2022 shoqëria “H&K @ Vala Mar Residences” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin respektiv.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin

financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "H&K @ Vala Mar Residences" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI